

1. PAMJE E PËRGJITHSHME

Zhvillimet e bilancit të pagesave për tremujorin e dytë të vitit 2001 karakterizohen nga tendenca në rritje të transaksioneve të Shqipërisë me botën. Vihet re një rritje e konsiderueshme e transaksioneve korente, e cila është shkaktuar kryesisht nga rritja e vlerës së transaksioneve të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve. Kështu vlera e transaksioneve korente vlerësohet rreth 790 milionë dollarë ose rreth 3 për qind më e lartë se periudha paraardhëse dhe 10 për qind më e lartë se tremujori i dytë i vitit të kaluar. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së shpenzimeve korente. Për rrjedhim, deficitit korent për tremujorin e dytë vlerësohet 99.7 milionë dollarë, respektivisht rreth 2 herë më i lartë se ai i tremujorit të parë. Bilanci thellësisht negativ i transaksioneve korente është mbuluar vetëm kryesisht prej importit të rritur të kapitaleve me rreth 84 për qind, pjesa e mbetur e deficitit korent është financuar nga transaksione të tjera të paidentifikuara të cilat reflektohen në zërin Gabime dhe Harresa¹.

Rezervat e autoritetit monetar janë rritur për 15.3 milionë dollarë amerikanë.

Kjo rritje është regjistruar kryesisht në mjetet valutore.

TABELA 1. BILANCI I PAGESAVE GJATË VITEVE (në mln usd)

¹ Në mungesë statistikave nga burimet zyrtare për statistikën e bilancit të pagesave disa shifra përmbajnë vlerësime të Bankës së Shqipërisë, për rrjedhim ajo rezervon të drejtën të revizionojë këto statistika kur të dhënat zyrtare të bëhen të vlefshme.

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	3M-II '00	3M-II '01
LLogaria Korrente	14.7	31.2	36.6	-62.4	-253.7	-45.2	-132.9	-155.6	-65.4	-99.7
Eksporti i mallrave fob	111.7	141.3	204.8	243.7	158.6	208.0	275.1	255.9	68.5	87.6
Importi i mallrave fob	-601.6	-601.0	-679.8	-922.0	-693.5	-811.7	-937.9	-1,070.1	-257.3	-321.1
Bilanci tregtar	-489.9	-459.7	-475.0	-678.3	-534.9	-603.6	-662.8	-814.1	-188.7	-233.5
Shërbimet: Kredi	77.5	83.1	98.2	127.3	67.9	94.6	266.7	448.1	89.2	108.2
Shërbimet: Debi	-162.0	-97.5	-106.3	-142.3	-101.1	-133.7	-165.4	-429.3	-91.9	-106.9
Të ardhurat: Kredi	64.9	55.6	70.8	83.5	61.6	86.1	85.6	115.9	32.3	38.0
Të ardhurat: Debi	-31.0	-41.5	-28.5	-12.0	-11.9	-8.7	-10.3	-9.1	-1.2	-1.9
Transferrat private	274.8	374.1	348.9	476.0	235.7	437.7	188.4	438.6	80.5	90.4
Transferrat shtetërore	280.4	117.2	128.5	83.4	29.0	82.5	165.0	94.4	14.5	6.0
Llogaria kapitale	0.0	21.6	389.5	4.9	2.1	31.1	67.5	78.2	19.5	27.8
Llogaria financiare	104.2	24.2	392.2	49.6	140.7	14.1	36.8	180.6	57.4	55.7
Investime direkte	58.0	52.9	70.0	90.1	47.5	45.0	41.2	143.0	30.0	43.2
Investime portofoli	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-25.0	0.0	-6.3
Kapitale të tjera	35.5	-6.9	-95.0	-35.6	95.3	0.6	-11.2	62.6	27.4	18.7
Gabime dhe harrësa	-9.9	-44.6	7.9	54.9	142.5	55.0	131.2	9.4	-9.7	31.6
Bilanci i përgjithshëm	114.9	54.8	30.6	47.0	43.8	63.3	116.7	131.9	5.0	15.3
Rezerva & zëra të lidhur me të										
Mjetet e rezervës	-114.9	-54.8	-30.6	-47.0	-43.8	-63.3	-116.7	-131.9	-5.0	-15.3
Përdor. kred. & huash nga fondi	16.6	22.2	11.1	0.0	12.2	7.9	20.9	19.3	3.1	0.0
Det. ndaj Auto. Monet. të Huaja
Financime të jashtëzakonshme
Për t'u përmendur										
Ndryshim i Rezervave	118.7	-54.8	-30.6	-39.5	-28.3	-75.9	-97.4	-130.5	-4.8	-8.1
Efektivi nga Kursi i Këmbimit	-3.8	7.3	5.1	-7.3	-15.5	12.6	-26.2	-3.5	-0.2	-10.5

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë

Aktiviteti i *tregtisë së jashtme* në mallra, gjatë tremujorit të parë, është rritur ndjeshëm dhe vlerësohet rreth 13.3 për qind më i lartë se ai i tremujorit të parë të vitit 2001 dhe ka çuar në thellimin e deficitit tregtar për 11 për qind. Rritja e volumit tregtar vjen si pasojë e rritjes së dy komponentëve të tregtisë së jashtme, eksportit ashtu dhe importit. Kështu, eksportet vlerësohen 16.2 për qind dhe importet 12 për qind më të larta se tremujori i paraardhës.


Edhe këtë tremujor tregtia është e orientuar drejt vendeve të Bashkimit Europian. Mëse 82 për qind e volumit të transaksioneve tregtare, përgjatë tremujorit, janë kryer me vendet e BE-së.

Zhvillimet në *tregtinë e shërbimeve*, për këtë tremujor, evidentojnë një rritje të vogël të shpenzimeve dhe tkurrjen e të ardhurave (ky fenomen është vërejtur pothuaj në të gjitha kategoritë e shërbimeve). Kështu, suficiti i bilancit të shërbimeve vlerësohet rreth 1.3 milionë dollarë amerikanë. Eksporti i shërbimeve vlerësohet në rreth 108 milionë dollarë dhe kjo është mundur kryesisht prej shërbimeve të turizmit, të cilat zënë rreth 86 për qind të këtyre të ardhurave, pjesën tjetër e përfaqësojnë shërbimet e telekomunikacionit dhe ato qeveritare. Importi i shërbimeve vlerësohet rreth 107 milionë dollarë. Edhe në shpenzimet për importin e shërbimeve peshën kryesore e zënë shërbimet e turizmit dhe ato të transportit, respektivisht me 60 dhe 24 për

qind. Këto të fundit janë rritur rreth 10 për qind kryesisht si pasojë e rritjes së importit.

Bilanci pozitiv i të ardhurave është rritur me 10 milionë dollarë ose 38 për qind më shumë se tremujori i parë. Kjo rritje është mundësuar kryesisht prej të ardhurave më të larta nga investimet e mjeteve valutore të sistemit bankar dhe të të ardhurave nga puna.

Transfertat korente vlerësohen me një bilanc pozitiv prej 96 milionë dollarësh. Rolin kryesor në transfertat korente e luajnë dërgesat nga emigrantët, që për këtë tremujor, vlerësohen rreth 104 milionë dollarë amerikanë. Vihet re një rënie e këtyre transfertave kundrejt tremujorit paraardhës. Rënie kanë pësuar edhe transfertat shtetërore. Për rrjedhim, bilanci pozitiv i transfertave korente vlerësohet 18 për qind më i ulët.




Grafik 1. LLOGARITË E BILANCIT TË PAGESAVE

Deficiti, relativisht i lartë, i transaksioneve korente është financuar prej *flukseve hyrëse të kapitaleve*, bilanci pozitiv i të cilave, në fund të periudhës, vlerësohet me rreth 83.4 milionë dollarë. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale prej rreth 28 milionë dollarësh dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 56 milionë dollarësh. Vihet re një rënie e dukshme e mjeteve valutore të zotëruara nga rezidentët shqiptarë, gjë që ka çuar në rënie të mjeteve financiare me 5.1 milionë dollarë.

2. LLOGARIA KORENTE

Tremujori i dytë pasqyron një rritje të volumit transaksioneve korente kundrejt tremujorit paraardhës edhe atij korrespondues një vit më parë, me rreth 3 dhe 10 për qind, duke regjistruar shifrën 790 milionë dollarë. Kjo rritje vjen kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve korente, të cilat në fund të tremujorit vlerësohen rreth 445 milionë dollarë, shifër kjo rreth 10 për qind më e lartë se tremujori paraardhës. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2000 këto shpenzime janë rritur rreth 13 për qind. Kështu, në fund të tremujorit të dytë të vitit 2001 deficitin i llogarisë korente vlerësohet rreth 99.6 milionë dollarë, shifër kjo rreth 1.5 herë më e lartë se tremujori i dytë i vitit të kaluar dhe rreth 2.1 herë kundrejt tremujorit paraardhës. Ky deficit është rrjedhojë kryesisht e deficitit tregtar të mallrave.



Grafik 2. LLOGARIA KORENTE DHE BILANCI FISKAL

Deficiti i llogarisë korente, përjashtuar transfertat shtetërore, këtë tremujor vlerësohet 1.3 herë më i lartë se e njëjta periudhë një vit më parë duke regjistruar shifrën 105 milionë dollarë.

2.1 TREGTIA E JASHTME

Tremujori i dytë, në aktivitetin tregtar regjistroi një nivel më të lartë se fillimviti. Volumi i përgjithshëm i tregtisë së jashtme, i cili brenda këtij tremujori ka


ardhur në rritje, u vlerësua rreth 409 milionë dollarë, rreth 12 për qind më i lartë se ai i tremujorit paraardhës dhe rreth 25 për qind më i lartë kundrejt tremujorit të dytë të vitit të kaluar. E gjithë kjo rritje i dedikohet si importeve ashtu edhe eksporteve.

Importi tregtar regjistroi rreth 321 milionë dollarë dhe përfaqëson 79 për qind të volumit tregtar. Krahasuar me tremujorin e parë të këtij viti dhe me tremujorin e dytë të vitit të kaluar, importi u vlerësua me një rritje prej 12 dhe rreth 25 për qind. Kanë ndikuar në këtë rritje zhvillimet pozitive në fushën e investimeve të brendshme duke rritur importin e makinerive dhe të pajisjeve.

Muaji qershor përfaqëson periudhën me volumin më të lartë të importit brenda tremujorit.

Eksporti i mallrave, i vlerësuar në rreth 88 milionë dollarë, regjistroi një rritje si kundrejt periudhës paraardhëse me rreth 11.5 për qind, ashtu edhe rreth 28 për qind, kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë. Rol kryesor në këtë rritje kanë luajtur eksportet nga prodhimi i brendshëm si dhe rieksperti për përpunim aktiv, kryesisht në grupmallrat tekstile dhe artikujt e tyre dhe produktet minerale, që janë grupmallrat mbizotërues në këto lloj eksportesh.

Edhe në eksport muaji prill ka kapur shifrën më të lartë në këtë tremujor.



Grafik 3. TENDENCA NË ECURINË E EKSPORTIT DHE TË IMPORTIT.

Importet ndihma vlerësohen rreth 3 milionë dollarë. Ndihamat ishin kryesisht në produkte të industrisë tekstile dhe në makineri e pajisje.

Rritja e volumit të importit në mallra u shoqërua me thellimin e deficitit tregtar. Kështu, në fund të këtij tremujori ai regjistroi rreth 234 milionë dollarë. Ky deficit vlerësohet rreth 24 për qind më i lartë se periudha korresponduese një vit më parë dhe rreth 13 për qind më i lartë se tremujori paraardhës. Rritja e deficitit tregtar ndaj kësaj periudhe është shkaktuar kryesisht nga grupmallrat produkte minerale dhe makineri e pajisje, produkte ushqimore dhe produkte vegjetale.

Rezerva valutore bruto, në fund të tremujorit të dytë të vitit 2001, vlerësohet e mjaftueshme për të përballuar 6.5 muaj importe (importe mallrash).

**Tabela 2. TREGTIA E JASHTME SIPAS TREMUJORËVE PËR PERIUdhËN '94-'01
(në mln usd)**


Period	Eksport	Ndryshimi ne % periudhen paraardhese	Import	Ndryshimi ne % periudhen paraardhese
Q1 1994	27.9	-19.7	-122.1	-29.7
Q2 1994	30.7	10.0	-149.0	22.1
Q3 1994	30.9	0.6	-155.0	4.0
Q4 1994	51.8	67.5	-174.9	12.8
Q1 1995	42.0	-19.0	-163.5	-6.5
Q2 1995	51.1	21.8	-177.0	8.2
Q3 1995	57.3	12.0	-150.4	-15.0
Q4 1995	54.5	-4.8	-188.8	25.5
Q1 1996	68.0	24.8	-208.4	10.3
Q2 1996	57.1	-16.0	-209.6	0.6
Q3 1996	56.5	-1.1	-225.2	7.4
Q4 1996	62.1	9.9	-278.8	23.8
Q1 1997	34.2	-44.8	-143.9	-48.4
Q2 1997	42.2	23.2	-114.5	-20.4
Q3 1997	41.3	-2.1	-171.1	49.3
Q4 1997	40.9	-0.9	-264.0	54.3
Q1 1998	42.2	3.2	-176.8	-33.0
Q2 1998	49.3	16.8	-198.1	12.1
Q3 1998	53.0	7.5	-196.1	-1.0
Q4 1998	63.4	19.6	-240.6	22.7
Q1 1999	72.9	15.0	-185.6	-22.9
Q2 1999	78.4	7.5	-250.1	34.8
Q3 1999	58.6	-25.2	-252.1	0.8
Q4 1999	65.1	11.1	-250.1	-0.8
Q1 2000	61.6	-5.4	-227.3	-9.1
Q2 2000	68.5	11.2	-257.3	13.2
Q3 2000	63.5	-7.3	-261.1	1.5
Q4 2000	62.2	-2.1	-324.3	24.2
Q1 2000	78.5	26.2	-288.5	-11.0
Q2 2001	87.6	11.6	-318.3	12.3

Struktura në eksporte dhe importe sipas përpunimit aktiv

Aktiviteti tregtar në fushën e përpunimit aktiv këtë tremujor u vlerësua në rritje dhe zuri një vend të rëndësishëm në tregtinë e vendit tonë, me 70 për qind në eksporte dhe 16 për qind në importe.

Eksporti këtë tremujor identifikohet në rritje, eksportet e brendshme me rreth 32 për qind kundrejt tremujorit të parë të vitit në vazhdim duke kapur nivelin e të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Rieksportet nga përpunimi aktiv janë rritur rreth 5 për qind kundrejt tremujorit të parë dhe rreth 44 për qind kundrejt periudhës korresponduese të vitit të kaluar. Këto rieksporte nga përpunimi aktiv, përfaqësojnë përgjithësisht aktivitetin e subjekteve me kapital të huaj, kryesisht në industrinë e veshjeve tekstile dhe përpunimin e lëkurëve, të cilat zënë përkatësisht 45 dhe 42 për qind të totalit dhe vazhdojnë të mbeten

grupmallrat kryesorë përpunuese në vend.



Grafik 4. BILANCI TREGTAR (në mln usd).

Importi për përpunim aktiv regjistroi zhvillime pozitive gjatë tremujorit të dytë të këtij vitit. Realizimi i impORTEVE të kësaj kategorie vlerësohet me rritje rreth 17 për qind kundrejt tremujorit të dytë të vitit të kaluar dhe rreth 5 për qind ndaj tremujorit paraardhës. Importi për përpunim aktiv hyn kryesisht si impORTE në tekstile, këpucë dhe lëkurë, përkatësisht në masat 33, 19 dhe 11 për qind. Importet në tekstile dhe këpucë regjistruan rritje prej 7 për qind kundrejt tremujorit korrespondues të vitit 2000, po kështu importet në lëkurë kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë janë rritur 1.2 herë.

Importi dhe eksporti sipas grupmallrave

Importi tregtar regjistroi tendenca në rritje përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2001 duke rregjistruar volumin prej 321 milionë dollarësh. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar importi vlerësohet 30 për qind më i lartë. Rol në këtë rritje ka luajtur importi i makinerive dhe pajisjeve gjë që reflekton tendencat pozitive në fushën e investimeve në vend.

Kështu, volumi i impORTEVE në makineri e pajisje u rrit rreth 2 herë kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe rreth 42 për qind ndaj tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Ky grupmall zë rreth 62 për qind të totalit të impORTIT. Italia dhe Greqia mbeten tregjet kryesore në këto impORTE.

	1996	1997	1998	1999	2000	korrik	gusht	shtator	tetor	netor	dhjetor	janar	shkurt	mars	prill	maj	qersh
Kafshët e gjalla; Produkte me origjine kafshore	47.1	27.4	42.4	41.4	30.3	2.7	1.5	2.1	2.7	2.5	3.0	1.7	1.8	2.5	2.2	2.3	2.5
Produkte vegjetale	163.0	85.3	83.0	85.9	90.7	5.8	7.7	6.3	6.0	6.4	11.4	7.8	9.0	9.1	10.1	8.9	6.7
Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	26.7	20.7	27.1	18.0	21.3	1.3	2.0	1.3	1.8	1.3	2.2	1.0	1.8	1.1	1.7	1.6	1.5
Ushqime të përgatitura, pije, duhan	88.5	47.0	73.0	108.8	97.6	8.8	8.5	9.2	8.4	8.3	8.4	7.6	6.9	8.8	8.0	10.0	7.5
Produkte minerale	48.6	49.2	70.0	81.3	141.7	11.6	12.5	12.7	11.8	22.4	16.7	15.9	13.8	17.9	15.5	8.9	15.1
Produkte të industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	45.1	38.3	61.8	51.4	60.4	5.5	5.1	5.0	4.3	3.4	6.0	3.6	6.1	6.4	7.4	5.9	6.1
Plastika; goma dhe artikuj të tyre	21.5	19.9	25.0	26.6	31.9	2.9	3.0	3.1	2.9	2.8	2.7	2.4	2.3	3.3	2.6	3.3	3.0
Lëkura, artikuj të tyre	19.8	14.4	19.0	21.1	19.0	1.7	0.8	1.6	1.4	2.2	1.6	1.9	2.6	2.3	1.8	2.4	1.9
Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	7.4	7.6	10.2	16.2	10.4	1.0	0.8	0.8	1.0	0.8	1.1	0.8	0.9	0.7	0.8	1.4	1.0
Brumi i drurit, letra, kartoni art. të tyre	13.4	8.5	12.8	14.3	17.0	1.8	1.4	1.8	1.5	1.2	1.6	1.2	1.2	1.5	1.5	2.0	2.2
Tekstile dhe artikuj tekstile	84.3	66.8	106.2	118.1	128.5	14.7	8.6	13.0	10.8	11.8	11.2	10.1	9.9	10.7	10.4	12.1	12.7
Veshjet e këmbëve, të kokës, cadrat	58.6	36.9	40.4	34.8	27.7	3.5	3.4	3.7	3.5	3.4	3.4	3.3	3.8	4.4	4.3	3.9	4.0
Art. prej guri, allcie, cimentoje; qeramike; qelq	22.3	22.3	28.7	30.1	41.9	3.8	3.1	4.7	3.9	4.0	4.1	2.6	3.3	2.8	3.9	4.8	4.2
Perla; bizhuteri; monedha	1.3	0.2	0.4	0.9	2.7	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	44.8	42.8	54.8	75.8	83.8	7.7	6.0	7.4	11.5	7.9	9.1	6.1	7.5	7.8	8.8	8.4	8.7
Makinieri e pajisje mekanike, elektrike	151.3	101.9	81.1	108.9	148.9	11.8	10.7	11.9	15.5	14.8	28.9	13.2	12.7	17.5	17.8	20.7	23.3
Mjete transporti	57.2	31.9	55.1	70.6	80.1	6.5	6.4	5.1	6.3	5.6	6.2	6.2	6.0	5.8	6.1	6.5	5.6
Instrumente e aparate optike; orë; instr. muzikore	12.4	8.1	8.7	13.1	18.6	1.9	1.8	1.8	1.7	0.6	4.1	2.1	0.7	2.1	0.8	1.1	1.7
Armë e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	0.7	0.5	0.7	2.0	0.4	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	19.1	14.6	21.4	23.6	26.0	2.5	1.8	2.0	2.5	2.6	2.5	1.5	1.9	2.0	2.0	2.5	3.9
Vepra arti, copa të mbledhura nga antikat	0.1	0.0	1.7	0.0	0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI	933.1	644.4	823.5	943.0	1079	92.1	81.9	90.2	97.6	101.9	124.8	89.3	92.5	106.7	105.6	106.9	112

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Statistikat e publikuara u përshtaten kornizave metodologjike të BOP.

TABELA 3. IMPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE.

Importi në produktet minerale, i cili këtë tremujor zë rreth 12 për qind të totalit të importeve, vlerësohet rreth 16 për qind më i ulët se tremujori paraardhës, por krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar importi në produkte minerale është rritur 41 për qind. Rritja e volumit të importuar në karburante përbën faktorin kryesor në importet në rritje të importit të produkteve minerale.

Grupmali tekstile dhe artikuj të tyre u vlerësua në rritje si ndaj ndaj periudhës paraardhëse ashtu edhe ndaj asaj të vitit të kaluar, respektivisht me rreth 15 dhe 12 për qind. Industria e përpunimit aktiv në vendin tonë mbetet e përqëndruar në përpunimin e mallrave tekstile. Italia përfaqëson tregun kryesor në këto importe.

Importi në grupmallin ushqim, pije dhe duhan, këtë tremujor, përfaqësoi 8 për qind të importeve dhe u karakterizua nga tendenca në rritje kundrejt tremujorit paraardhës me rreth 9 për qind, ndërkohë që ka ruajtur nivelin e importeve të periudhës korresponduese të një viti më parë.

Grupmali metalet bazë dhe artikujt prej tyre regjistroi një shifër rreth 28 për qind më të lartë se periudha korresponduese një vit më parë duke zënë rreth 8 për qind të totalit të importeve. Ndër importet brenda këtij grupmali përmendim importet e hekurit, të çelikut dhe artikujt prej gize, të cilat ndikojnë ndjeshëm në këtë rritje.

Importet në mjete transporti, kanë ruajtur të njëjtin nivel me tremujorin

paraardhës, por paraqiten me rënie kundrejt një viti më parë, me rreth 14 për qind.

Ndërkohë që, ritme pozitive shfaqti importi në grupmallin produkte të industrisë kimike kundrejt tremujorit paraardhës prej rreth 20 për qind. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar importi në këtë grupmall vlerësohet rreth 42 për qind më i lartë.

Eksporti tregtar paraqitet me rritje si kundrejt tremujorit paraardhës ashtu edhe ndaj periudhës korresponduese të vitit 2000. Rritja e eksporteve është rrjedhojë kryesisht e rritjes në grupmallrat kryesorë tekstile dhe artikuj të lëkurës dhe metale bazë.

Eksporti në grupmallin tekstile dhe artikuj të tyre, i ardhur kryesisht nga industria e përpunimit në vend, kryeson eksportet tona në një total prej 32 për qind të volumit. Këtë tremujor, eksportet e këtij grupmali u rritën me 12 për qind kundrejt periudhës korresponduese të vitit të kaluar, ndërkohë që, krahasuar me periudhën paraardhëse, këto kanë rënë me rreth 8 për qind.

Tabela 4. EKSPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE.

	1996	1997	1998	1999	2000	korrik	gusht	shtator	tetor	ntor	dhjetor	janar	shkurt	mars	prill	maj	qersh	
Kafshët e gjalla; Produkte me origjinë kafshore	6.9	4.1	4.1	3.4	1.8	0.2	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.3	0.4
Produkte vegjetale	16.0	15.5	16.2	12.6	12.1	1.2	1.4	1.4	1.2	1.2	0.7	1.0	0.8	1.1	0.7	0.6	0.7	
Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	4.8	0.0	0.5	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Ushqime të përgatitura, pije, duhan	9.2	9.0	12.6	12.7	13.7	1.6	1.3	1.6	2.1	0.9	0.5	0.7	0.8	1.0	0.5	1.0	1.3	
Produkte minerale	23.1	8.4	23.7	17.5	7.4	0.6	0.5	0.3	0.2	0.1	0.2	0.1	2.3	0.5	1.3	0.1	0.1	
Produkte të industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	2.6	1.2	0.7	0.7	1.4	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.5	0.1	0.2	
Plastika; goma dhe arikuj të tyre	1.2	0.5	1.1	1.3	0.9	0.2	0.0	0.1	0.0	0.0	0.1	0.0	0.2	0.0	0.1	0.0	0.1	
Lëkura, artikuj të tyre	10.2	8.2	6.6	7.0	8.3	0.6	0.6	0.8	0.7	0.8	1.0	1.1	0.9	1.2	1.2	1.2	1.0	
Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	6.2	5.3	5.6	6.4	7.3	0.8	0.3	1.1	0.7	0.7	0.5	0.5	0.9	0.8	0.6	0.7	0.6	
Brumi i drurit, letra, kartoni art. të tyre	3.1	3.7	2.9	4.6	2.6	0.1	0.1	0.3	0.2	0.2	0.3	0.2	0.1	0.1	0.2	0.1	0.2	
Tekstile dhe artikuj tekstile	54.7	36.2	69.6	98.3	108.7	16.4	9.3	13.6	6.5	7.4	8.1	8.9	10.4	11.4	8.9	8.6	10.8	
Veshjet e këmbëve, të kokës, cadrat	52.6	27.4	40.7	67.9	69.0	6.6	2.7	4.9	5.5	5.9	6.6	6.5	7.6	9.0	9.4	9.7	7.5	
Art. prej guri, allçie, cimentoje; qeramike; qelq	0.4	0.4	1.7	0.6	0.7	0.1	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3	0.1	
Perla; bizhuteri; monedha	0.1	0.1	0.2	0.8	0.5	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	4.2	0.0	
Metalet bazë dhe artikuj prej tyre	25.4	14.3	9.4	14.6	21.5	1.9	1.8	1.8	2.2	1.7	1.4	2.4	2.3	2.3	2.4	2.9	2.9	
Makineri e pajisje mekanike, elektrike	3.8	7.4	4.3	12.4	4.4	0.4	0.2	0.5	0.7	0.4	0.2	0.3	0.4	0.3	1.4	1.6	0.7	
Mjete transporti	0.1	0.5	1.2	5.0	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0	
Instrumente e aparate optike; orë; instr. muzikore	0.2	0.1	0.8	0.4	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Armë e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	0.7	0.0	0.0	0.0	1.7	0.0	0.0	0.0	0.5	0.5	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	3.2	3.4	6.1	7.9	7.1	0.6	0.2	0.7	0.0	0.7	0.0	0.4	0.5	0.4	0.4	0.6	0.6	
Vepra arti, copa të mbledhura nga antikitet	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
TOTALI	224.5	145.9	208.0	274.4	255.9	24.9	16.1	22.5	20.8	21.0	20.4	22.5	27.4	28.6	31.8	27.9	27.8	

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Statistikat e publikuara u përshtaten kornizave metodologjike të BOP.

Eksporti në grupmallin veshje koke që përfaqëson rreth 30 për qind të totalit të eksporteve është rritur me rreth 14.9 për qind nga tremujori paraardhës dhe njëkohësisht paraqitet me një rritje prej 52.7 për qind kundrejt tremujorit të dytë të vitit 2000.

Eksporti në metale bazë vazhdon të ndjekë tendencat pozitive të zhvillimit të këtij fillimviti. Kështu tremujori i dytë regjistroi një rritje prej 33.4 për qind kundrejt periudhës korresponduese të vitit 2000 dhe rreth 17 për qind të periudhës paraardhëse. Metalet përfaqësojnë grupmallin kryesor në eksportin e brendshëm.

Eksporti në produkte minerale pësoi një rënie si ndaj tremujorit paraardhës ashtu edhe krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë, respektivisht 3.5 dhe 2 herë.

Partnerët tregtarë

Aktiviteti tregtar i Shqipërisë me botën zhvillohet me orientimin kryesor vendet e Bashkimit European. Mëse 82 për qind e transaksioneve tregtare, përgjatë tremujorit, janë kryer me vendet e BE-së. Tregtia me këto vende vlerësohet në rritje kundrejt tremujorit korrespondues të një viti më parë (18 për qind). Kështu importi me këto vende përfaqëson 79 për qind, ndërsa eksporti 86 për qind. Edhe këtë tremujor Italia rezulton partneri më i madh i Shqipërisë në tregti me 60 për qind të volumit tregtar, pasuar nga Greqia me 20 për qind.

Tregtia me vendet e Europës Lindore ka ruajtur nivelin e këtij fillimviti. Aktiviteti tregtar me Rusinë, Bullgarinë dhe Slloveninë përfaqëson tregtinë me vendet e Europës Lindore. Me pjesën tjetër të botës, tregtia e zhvilluar kryesisht me Turqinë, Maqedoninë, SHBA, Kroacinë dhe Jugosllavinë, vlerësohet 41 për qind më e lartë ndaj tremujorit korrespondues një vit më parë.

Shkëmbimet tregtare me Italinë

Italia mbetet kryesuese në aktivitetin tregtar të Shqipërisë me botën. Kundrejt tremujorit paraardhës të vitit në vazhdim, tregtia me Italinë, si volum, paraqiti një rritje prej 1.7 për qind duke regjistruar rënie në importe me 9.2 për qind dhe një rritje në eksporte me 27 për qind. Ndërkohë, krahasuar me tremujorin e parë, volumi i tregtisë me Italinë është rritur 16.4 për qind. Kjo rritje pasqyrohet në të dy komponentët e saj si në eksport me 29 për qind ashtu

edhe në import me rreth 10 për qind. Aktiviteti tregtar me Italinë përfaqësohet nga eksporti për përpunim aktiv në artikujt e përpunuar dhe nga importi në grupmallrat makineri e pajisje dhe tekstile dhe artikujt e tyre, të cilat zënë respektivisht 23 dhe 15 për qind të importeve me këtë shtet.

Shkëmbimet tregtare me Greqinë.

Aktiviteti tregtar me Greqinë, gjatë këtij tremujori u vlerësua 10.7 për qind më i lartë, krahasuar me tremujorin paraardhës. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së importit me 13 për qind, ndërkohë që eksporti ra me 11 për qind. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2000 tregtia me këtë shtet, gjatë këtij tremujori, ka shënuar ritme pozitive. Kështu, volumi tregtar është rritur rreth 27.5 për qind; me një rritje prej 29 për qind në importe dhe rreth 11.6 për qind në eksporte. Grupmallrat kryesorë në importe janë makineri e pajisje, produkte minerale, ushqime, pije dhe duhan, të cilat zënë respektivisht 18, 16 dhe 13 për qind të importeve me këtë shtet.

Shkëmbimet tregtare me Gjermaninë

Aktiviteti tregtar me Gjermaninë vlerësohet në rritje si volum kundrejt periudhës korresponduese një vit më parë. Rritja e këtij volumi vjen si rezultat i rritjes së importeve me 24 për qind ndërkohë që eksportet kanë rënë me 13 për qind. Krahasuar me tremujorin paraardhës, importet me Gjermaninë u rritën me rreth 9 për qind rritje kjo, e cila u balancua me rënie në eksporte. Importet e larta në mjete transporti, të cilat zënë rreth 34 për qind të importit me Gjermaninë, përbëjnë shkakun kryesor në rritje të volumit të importit, pasuar nga importet e grupmallit makineri e pajisje (me 21 për qind të totalit).

2.2 SHËRBIMET


Bilanci i shërbimeve këtë tremujor u mbyll me një bilanc pozitiv prej 1.3 milionë dollarësh dhe zë vetëm 8 për qind të suficitit të tremujorit paraardhës. Kjo rënie e suficitit vjen si rezultat i tkurrjes së të ardhurave. Kështu, eksporti i shërbimeve ka rënë me 12 për qind kundrejt tremujorit paraardhës dhe vlerësohet rreth 108 milionë dollarë. Megjithatë, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë kjo shifër është rritur me rreth 21 për qind. Importi i shërbimeve, këtë tremujor, regjistron 107 milionë dollarë dhe vlerësohet i

rritur me 1.4 për qind kundrejt tremujorit të parë dhe me rreth 16 për qind kundrejt periudhës korresponduese një vit më parë. Gjithashtu, rritja e importit tregtar ka çuar në rritjen e shpenzimeve për shërbimet e transportit me 7 për qind kundrejt tremujorit të parë ashtu edhe kundrejt tremujorit të dytë të vitit 2000.

Peshën kryesore në transaksionet e shërbimeve, prej 73 për qind, e zënë shërbimet e turizmit, pjesën tjetër e zënë shërbimet e telekomunikacionit dhe ato qeveritare.

Të ardhurat e turizmit kanë regjistruar 93 milionë dollarë duke rënë me 9 për qind ndaj tremujorit të parë. Megjithëse numri i turistëve që kanë vizituar Shqipërinë është rritur, arsyeja kryesore e kësaj është rënia e shpenzimeve ditore për turist. Megjithatë, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë, të ardhurat nga turizmi janë rritur me 22 për qind.

Shpenzimet e turizmit gjatë këtij tremujori janë rritur vetëm me rreth 2 për qind kundrejt tremujorit paraardhës, ndërkohë që kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë këto janë rritur me rreth 16 për qind.



Grafik 5. BILANCI I SHËRBIMEVE.

2.3 TË ARDHURAT

Bilanci pozitiv i të ardhurave këtë tremujor regjistroi rreth 36 milionë dollarë. Ky suficit vlerësohet me një rritje prej rreth 38 për qind kundrejt tremujorit paraardhës dhe rreth 19 për qind kundrejt tremujorit të dytë të vitit të kaluar.

Një rol të rëndësishëm në këtë rritje kanë luajtur të ardhurat nga investimet e mjeteve valutore të sistemit bankar, të cilat këtë tremujor janë rritur me 33 për qind dhe nga ardhurat nga puna e punëtorëve sezonalë .


2.4 TRANSFERTAT

Tremujori i dytë i këtij viti u mbyll me një suficit të transfertave korente prej 96 milionë dollarësh. Këto transferta kanë mbuluar rreth 41 për qind të deficitit tregtar të mallrave.

Ky bilanc vlerësohet rreth 1,5 herë më i lartë se ai i periudhës korresponduese të vitit 2000 dhe me një rënie prej rreth 1.2 herë kundrejt atij të tremujorit të parë. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rënies së transfertave private ashtu edhe shtetërore.

Dërgesat nga emigrantët, për këtë tremujor, vlerësohen në rënie si ndaj periudhës paraardhëse me 16 për qind ashtu edhe ndaj asaj korresponduese një vit më parë, me rreth 14 për qind dhe regjistrojnë rreth 105 milionë dollarë.


Gjithashtu, transfertat shtetërore këtë tremujor kanë rënë me rreth 16 për qind (ndërkohë këto përfaqësojnë vetëm 41 për qind të transfertave të tremujorit të dytë të vitit të kaluar).



Grafik 6. STRUKTURA E TRANSFERTAVE .

3. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Deficiti relativisht i lartë i transaksioneve korente është financuar rreth 84 për qind prej flukseve të kapitaleve, bilanci pozitiv i të cilave, në fund të periudhës, vlerësohet me rreth 83 milionë dollarë.



Grafik 7. FLUKSET FINANCIARE (në mln usd)

Ky import neto kapitalesh vlerësohet i rritur me rreth 52 për qind kundrejt tremujorit të parë të këtij viti, dhe rreth 4 për qind kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë. Transfertat kapitale vlerësohen rreth 28 milionë dollarë, dhe flukset financiare regjistrojnë rreth 56 milionë dollarë, shifër kjo rreth 2.1 herë më e lartë se tremujori i parë. Kjo rritje i dedikohet rënies së mjeteve financiare.

3.2 DETYRIMET FINANCIARE


Detyrimet financiare të ekonomisë shqiptare, gjatë tremujorit, u rritën rreth 51 milionë dollarë. Kjo rritje përfaqëson rreth 60 për qind të rritjes së tremujorit paraardhës, por vlerësohet rreth 7 për qind më e lartë se ajo e periudhës korresponduese një vit më parë. Rritja e detyrimeve financiare përfaqësohet kryesisht në formën e investimeve të huaja direkte² dhe huamarrjes së linjave të kredive të huaja.

² shih shpjeguesin metodologjik.

Investimet e huaja direkte, këtë tremujor, vlerësohen rreth 43 milionë dollarë. Kjo shifër është rreth 44 për qind më e lartë se ajo e tremujorit të dytë të vitit të kaluar. Rritja e këtyre flukseve kapitale vazhdon të reflektojë kryesisht efektin e privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha shtetërore, të cilat janë shndërruar në një fenomen dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare.

Borxhi i jashtëm. Kapitaleve të investuara në formën e investimeve direkte i janë shtuar dhe disbursimet e kredive të huaja. Këto disbursime, këtë tremujor, regjistruan rreth 22 milionë dollarë. Këto vlerësohen rreth 35 për qind më të larta se e njëjta periudhë një vit më parë.

Disbursimet kanë shkuar pothuajse tërësisht në favor të sektorit “Qeveria e Përgjithshme” dhe përfaqësojnë rritjen e detyrimeve të këtij sektori. Financuesi kryesor i qeverisë, ashtu sikurse edhe më parë, mbetet Banka Botërore.



Grafik 8. DETYRIMET NDAJ KREDITORËVE TË HUAJ.

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë tremujorit të dytë të vitit në vazhdim regjistruan rreth 11 milionë dollarë, dhe u vlerësuan 2.5 herë më të larta se tremujori paraardhës. Në këto pagesa, rreth 42 për qind e zënë pagesat e principalit të përdorimit të kredive në fond.

Detyrimet financiare në formën e **depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar** kanë rënë me 4.1 milionë dollarë amerikanë. Depozitat janë kryesisht

në USD, të cilat zënë rreth 65 për qind të totalit dhe pasohen nga ato në DEM GRD, dhe LIT me rreth 20 për qind.

Ndryshe nga tremujori paraardhës, i cili ka regjistruar një shifër negative prej rreth 7 milionë dollarësh, tremujori i dytë pati një rritje të vogël prej 0.4 milionë dollarësh. Kjo rritje zë vetëm 28 për qind të së njëjtës periudhë një vit më parë.


3.2 MJETET FINANCIARE

Mjetet financiare këtë tremujor kanë rënë me rreth 5 milionë dollarë. Kjo rënie ka ardhur kryesisht si rezultat i rënies së mjeteve tona financiare në formën e depozitave në bankat e huaja. Kështu, depozitat tona vlerësohen me një rënie prej rreth 26 milionë dollarësh.

Investimet e portofolit janë rritur me rreth 6.3 milionë dollarë.

4. REZERVAT

Flukset hyrëse në mjete valutore në formën e kapitaleve financiare (kryesisht disbursimet e kredive të huaja dhe investimet e huaja direkte nga privatizimi) dhe transfertave korente në *cash* u reflektuan në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar me 15.3 milionë dollarë (rreth 3 herë më e lartë se ajo e tremujorit të dytë të vitit të kaluar). Kjo rritje është regjistruar kryesisht në mjetet valutore. Niveli i rezervave valutore në fund të vitit ishte i mjaftueshëm për të përballuar 4.7 muaj importe (import mallrash dhe shërbimesh).



Grafik 9. REZERVAT E AUTORITETIT MONETAR.